



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2020/5 Prot

Tiranë, më 18.10.2024

VENDIM

Nr. 19, datë 18.10.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2020 Prot., datë 12.09.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Vorë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës me datë 17.07.2024, depozituar në adresën elektronike ledamarku1@gmail.com, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Kopje të kontratave të nënshkruara midis Bashkisë dhe kompanisë/kompanive së menaxhimit të mbetjeve për vitin 2023 dhe 2024;*
2. *Sa është buxheti i parashikuar për menaxhimin e mbetjeve për vitin 2023 dhe 2024.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me

përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 2020/1 prot., datë 13.09.2024, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, brenda datës 20.09.2024.

Me kalimin e afatit të sipërcituar, Autoriteti Publik nuk ndërmori asnjë masë, për të bërë të mundur vendosjen në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, apo të argumentonte mosdhënien e tij.

Po ashtu, Zyra e Komisionerit ka kontaktuar në vazhdimësi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, e cila ka bërë me dije se kërkesa për informacion është dërguar për trajtim dhe po përgatitet informacioni/dokumentacioni i kërkuar nga strukturat përkatëse pranë Autoritetit Publik.

Për këtë, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion, me Urdhrin nr. 171, datë 10.10.2024, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, duke filluar nga data 14.10.2024. Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 5476 Prot., datë 11.10.2024.

Gjatë inspektimit, u kontaktua me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, e cila sqaroi se: *“Kërkesa për informacion nga Qendra “Res Publica” ka ardhur në adresën time si koordinatore për të drejtën e informimit pranë bashkë në datë 17.07.2024, e cila u protokollua pranë protokollit me nr. 4092 prot., datë 17.07.2024. Shkresa shkoi te nënkryetari për tu sigluar. Në datën 19.07.2024 më ka ardhur shkresa nga protokollit për të bërë bashkrendimin dhe kthimin e përgjigjes së kërkesës për informacion. Për këtë me shkresën me protokoll të brendshëm nr. 24 prot., datë 24.07.2024 i jam drejtuar zyrës së Financës dhe Zyrës së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik për kthimin e përgjigjes brenda afatit 5 ditor. Që nga kjo datë nuk kam marrë përgjigje edhe pse në vazhdim kam qenë në kontakt me drejtorinë përkatëse për kthimin e përgjigjes”*.

Ndodhur në këto kushte, për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. grupi i inspektimit kontaktoi me përfaqësuesin pranë Autoritetit Publik z. Taulant Fejzulla, Sekretar i Përgjithshëm, i cili në periudhën e administrimit të kërkesës, ishte në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik dhe ka trajtuar praktikën në fjalë. Gjatë inspektimit z. Fejzulla sqaroi se: *“Në lidhje me kërkesën për informacion të Qendrës “Res Publica” jam bërë me dije nëpërmjet protokollit të*

brendshëm nr. 34 prot., datë 24.07.2024. Nga ana jonë edhe pse më vonesë në kthimin e përgjigjes kërkojmë mirëkuptimin e Zyrës së Komisionerit për të rivlerësuar qëndrimin tonë brenda datës 16.10.2024”.

Në vijim, Autoriteti Publik me e-mail-in datë 16.10.2024, bën me dije se me shkresën nr.4092/1 Prot., datë 16.10.2024, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“Bashkia Vorë në përputhje të të gjitha detyrimeve ligjore në fuqi ka nënshkruar kontratën “tip” (sipas udhëzimeve të APP) sipas modeleve të përcaktuara në DST, me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë” me një afat të përcaktuar 3 vite. Në kreun V, Neni 42. Pika 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht: 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*

Përsa i përket buxhetit të parashikuar për vitet të cilat ju kërkoni informacion, konkretisht viti 2023 dhe viti 2024, Bashkia Vorë, në parashikimin e buxhetit afatgjatë të miratuar në këshillin Bashkiak me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, sipas dhe regjistrimit të parashikimeve të prokurimit publik vlera për këto vite është 91 153 407 lekë.

Në linkun e mëposhtëm do të gjeni modeli e kontratës së lidhur dhe formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar nga Bashkia Vorë.

Open procurement

<https://prokurimettransparente.al/tenders/kriteret/167299156147636dst.pdf>

Buletini i njoftimeve publike

<https://www.app.gov.al/GetData.DoenloadDoc?documentId=e34d478c-3a09-48f4-a05c-ed776033dea7>”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me e-mail-in datë 16.10.2024, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2020/4 Prot., datë 17.10.2024, ka sqaruar se Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje për pikën e dytë të kërkesës për informacion, ndërkohë për pikën e parë, ka vijuar ankimin me pretendimin se: *“...Në përgjigjen e tij autoriteti publik, ka vënë në dispozicion linkun ku gjendet njoftimi për tenderim për shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave në Bashkinë Vorë, por nuk ka vënë në dispozicion kopjen e kontratave të nënshkruara me kompanitë për menaxhimin të mbetjeve për vitin 2023 dhe 2024 i cili përbën edhe objektin e kërkesës sonë.*

Gjithashtu bëjmë me dije se kontratat e nënshkruara nuk publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe e vetmja mënyrë për tu informuar lidhur me to është duke kërkuar një kopje pranë autoritetit kontraktor”.

Pas konsultimit të legjisllacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Vorë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhje detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”*. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e *“prodhuesit”* apo *“mbajtësit”* të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me kontrata të punëve publike, të zhvilluara nga Autoriteti Publik, të cilat i nënshtrohen dispozitave ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

Konstatohet se Autoriteti Publik, në përgjigjen dhënë ankuesit, i ka vendosur në dispozicion linkun përkatës të faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilin gjendet modeli i kontratës *“tip”* të lidhur dhe formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar nga Autoriteti Publik. Ky dokumentacion, nuk përkon me objektin e kërkesës për informacion, objekt të ankimit *“Kopje të kontratave të nënshkruara midis Bashkisë dhe kompanisë/kompanive së menaxhimit të mbetjeve për vitin 2023 dhe 2024”*, që sipas procedurave të prokurimit publik, këto të fundit (*Kontratat e nënshkruara*) nuk publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Rrjedhimisht, duke mos i vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar ankuesit.

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Pikërisht, është pika 6 e nenin 17 të ligjit të sipërcituar, e cila përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*. Rezulton se, Autoriteti Publik në asnjë rast, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, nuk ka argumentuar apo të bënte një analizë të mirëfilltë, në lidhje me mosdhënien e informacionit sipas kësaj dispozite.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*. Në këtë kuptim, Autoriteti

Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Gjithashtu, detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njërive të qeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njërive të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”*.

Bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare, konkretisht në linkun <https://idp.al/vendime-2022/>, si vendimi Nr. 14, datë 13.05.2022, vendimi Nr. 40, datë 25.10.2022, etj.

Në këto kushte, pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe deklarimit gjatë inspektimit të kryer, Komisioneri konstaton se, z. Taulant Fejzulla, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, është personi përgjegjës i cili nuk ka përmbushur detyrimin për kthimin e përgjigjes së kërkesës për informacion, rrjedhimisht që ka refuzuar dhënien e informacionit.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 18, pika 2, shkronja a) të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë veprë penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë: a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 300 000 lekë;...”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 2020 Prot., datë 12.09.2024 nga Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik, “Bashkia Vorë”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 17.07.2024, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, konkretisht: *“- 1. Kopje të kontratave të nënshkruara midis Bashkisë dhe kompanisë/kompanive së menaxhimit të mbetjeve për vitin 2023 dhe 2024”*, brenda datës 25.10.2024.
3. Dënimin e z. Taulant Fejzulla, Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit Publik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 18.10.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi